



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 248, Datë 29.09.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GOSTIMA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 3047 KW, “GOSTIMA 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5586 KW, “GOSTIMA 3” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5335 KW, “GOSTIMA 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 7396 KW, “GOSTIMA 5” ME KAPACITET TË INSTALUAR 10321 KW, “GOSTIMA 5/1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 450 KW DHE “GOSTIMA 6” ME KAPACITET TË INSTALUAR 16819 KW ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 48 864 kW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 10 pika 3 dhe 11 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1625/2 prot., datë 26.09.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “GOSTIMA 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, GOSTIMA 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, GOSTIMA 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, “GOSTIMA 4” me kapacitet të instaluar 7396 “ GOSTIMA 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, “GOSTIMA 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe “GOSTIMA 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW me kapacitet total të instaluar 48 864 kW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 120, datë 24.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/21 prot., datë 24.05.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 05.07.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Duke qenë se nga shoqëria nuk u plotësua i gjithë dokumentacioni i aplikimit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 211, datë 17.08.2022 vendosi të shtyjë me 30 ditë pune vendimmarrjen e tij për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në mënyrë që t'i jepej mundësia shoqërisë për të plotësuar pjesën e mbetur të dokumentacionit.
- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k. ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e këtij aplikimi, në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Duke qenë se aktualisht rregullimi pronësor është bërë nëpërmjet kontratave të qirave afatgjata (që i shërbejnë edhe ndërtimit të HEC-eve), në përfundim të afatit të tyre (Kontratë qiraje nr. 782, datë 09.04.2021, me Bashkinë Përrenjas, afati i përfundimit, datë 25.03.2031; Kontratë qiraje nr. 2449 prot., datë 29.04.2021, me Bashkinë Librazhd, afati i përfundimit 07.01.2031 dhe Kontratë qiraje nr. 2589 prot., datë 10.06.2021, afati i përfundimit 31.12.2030), do t'i kërkohet shoqërisë t'i depozitojë të rinovuara në ERE, apo të përcjellë çdo dokument tjetër që mund të rregullojë pronësinë në vijim.
- Kontrata e Koncesionit e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Gostimë (Egnatia-Shushicë), me nr. 4 REP, nr. 1 KOL, datë 20.02.2013, ka një afat 35 – vjeçar. ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet, por në rast të kostatimit të humbjes së periudhës së koncesionit, licenca do të jepet për periudhën e mbetur të koncesionit. Në rastin konkret periudhës së koncesionit i kanë mbetur 25 vjet e 5 muaj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, “Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, “Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, “Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, “Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW,

“Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe “gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW me kapacitet total të instaluar 48 864 kW, për një afat 25 vjet e 5 muaj.

2. Shoqëria “Egnatia Hydropower” sh.p.k., të përcjellë në ERE me afat të rinovuar kontratën e qirasë me Bashkinë Përrenjas jo më vonë se data e përfundimit të saj (datë 25.03.2031); Kontratën e qirasë me Bashkinë Librazhd jo më vonë se data e përfundimit të saj (datë 07.01.2031); Kontratën e qirasë me Bashkinë Elbasan jo më vonë se data e përfundimit të saj (datë 31.12.2030), ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku do të shtrihet projekti.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI